



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

KOMISIONI VLERËSUES

V E N D I M

Nr. 3/6 Datë 28/08/2018

PËR

**SHPALLJEN E SUBJEKTEVE FITUES NË KONKURSIONIN E HAPUR,
PËR LINJAT E REJA NDËRQYTETËSE UDHËTARËSH, TË
MIRATUARA ME UDHËZIMIN NR. 437, DATË 08.06.2018**

Në zbatim të urdhërit nr.420, datë 27.04.2018 "Për ngritjen e komisionit vlerësues për shqyrtimin e aplikimeve dhe marrjen e vendimeve, për përzgjedhjen me konkurs të hapur të subjektit kandidat për të operuar në linjë të rregullt ndërqytetëse udhëtarësh", të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë" dhe vendimit nr. 3, datë 08/06/2018 dhe 3/2, datë 24.07.2018. "Për fillimin e konkursit të hapur, për linjat e reja ndërqytetëse udhëtarësh, të miratuara me udhëzimin nr.437, date 08.06.2018", Komisioni Vlerësues i mbledhur më datë 28.08.2018 ora 12.00, në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë,

VENDOSI:

Në vijim të vendimit nr. 3/2, datë 24.07.2018, të Komisionit të Vlerësimit, subjektet e mëposhtëme, në linjat respektivisht si më poshtë vijon:

1. LINJA NDËRQYTETËSE KUKËS – KAMËZ – KUKËS.

- "FAT-5" shpk, me numër unik identifikimi K37509289U, me adresë: Lagjia nr.1, Rruga Pavarsia, Ndërtesë private nr.45, **Kukës.**
- "LAÇI KOMPANI" shpk, me numër unik identifikimi L27917201V, me adresë: Lagjia nr. 1, Rr. "Kukësi i Vjetër", **Kukës.**
- "MYÇI 8" shpk, me numër identifikimi L67828201I, me adresë Lagjia nr.5, Rruga Dituria, Pallati nr.5, Shk. nr.3, **Kukës.**

LINJA NDËRQYTETASE PËR BASHKINË KUKËS

Nr	LINJA KRYESORE	Nr. Orareve	Nr. Autobusave
1.	KUKËS – KAMËZ - KUKËS	4 (katër)	5 (pesë)

Dokumentacioni për linjën ndërqytetëse Kukës – Kamëz – Kukës, në zbatim të udhëzimit nr. 5627, datë 18.11.2016, të ndryshuar, i subjekteve “Fat-5” shpk, “Laçi Kompani” shpk dhe “Myçi 8” shpk, pasi i plotesuan, janë të saktë dhe të plotë.

Vlerësimi me pikë për këto subjekte është si më poshtë:

TABELA E SISTEMIT TË VLERËSIMIT ME PIKË

NR.	EMËRTIMI	Vlera pikëve	Fat-5	Myçi-8	Laçi Kompani
5	Për autobusë me vit prodhimi 4 vjet÷ ≥ 5 vjet	26		X	
9	Për autobusë me vit prodhimi 8 vjet÷ ≥ 9 vjet	22	X	X	
11	Për autobusë me vit prodhimi 10 vjet÷ ≥ 11 vjet	20	X		
12	Për autobusë me vit prodhimi 11 vjet÷ ≥ 12 vjet	19		X	
13	Për autobusë me vit prodhimi 12 vjet÷ ≥ 13 vjet	18		X	
14	Për autobusë me vit prodhimi 13 vjet÷ ≥ 14 vjet	17	XX		
15	Për autobusë me vit prodhimi 14 vjet÷ ≥ 15 vjet	16	X	X	
16	Për autobusë me vit prodhimi 15 vjet÷ ≥ 16 vjet	14			X
20	Për autobusë me vit prodhimi 19 vjet÷ ≥ 20 vjet	6			X
21	Për autobusë me vit prodhimi > 20 vjet	3			XXX
22	Për autobusë në pronësi të aplikantit 100 %	12			X
23	Për autobusë në pronësi të aplikantit > 75 %	10	X		
26	Për autobusë pronësi aplikantit 10 %÷ ≥ 25 %	4		X	
27	Për eksperiencë të subjektit në transportin e udhëtarëve ÷ ≤ 3 vjet	1		X	
29	Për eksperiencë të subjektit në transportin e udhëtarëve 5 ÷ ≤ 10 vjet	6			X
31	Për eksperiencë të subjektit në transportin e udhëtarëve 15 ÷ ≤ 20 vjet	10	X		
33	TOTALI		112	106	47

Në bazë të vlerësimit me pikë renditja e subjekteve është si më poshtë:

- a) **I PARI, “FAT - 5” shpk, 112** (njëqind e dymbëdhjetë) pikë.
- b) **I dyti, “MYÇI 8” shpk, 106** (njëqind e gjashtë) pikë.
- c) **I treti, “LAÇI KOMPANI” shpk, 47** (dyzet e shtatë) pikë.

Komisioni Vlerësues për subjektet e mësipërme, në vijim të vendimit nr. 3/2, datë 24.07.2018, të Komisionit të Vlerësimit, riverifikoi plotësimin e dokumentacionin nga mangësitë e konstatuara, për plotësimin sipas kriterëve të detyrueshme të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

(Handwritten signatures)

Për subjektet e mësipërme që plotësojnë dokumentacionin me mangësitë e konstatuara, pasi ju rivefikua dokumentacioni, dhe meqenëse tashmë kanë dokumentacion të saktë dhe të plotë, në bazë të renditjes nga vlerësimi me pikë, **Komisioni Vlerësues, Miratoi si fitues në linjën ndërqytetëse respektive, subjektin në renditje “I PARI”, i cili është si më poshtë:**

1. **“FAT-5” shpk për linjën ndërqytetëse Kukës – Kamëz – Kukës.**

Për subjektin dhe linjën ndërqytetëse respektive të mësipërme, që **Komisioni Vlerësues Miratoi, Sektori i licensave të lëshojë Licensën dhe Certifikatat përkatëse**, me oraret e kërkuara nga subjekti respektiv, dhe të miratuar nga sektori i licensave, në zbatim të udhëzimit të ministrit nr.438, datë 09.05.2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në udhëzimin nr. 5627, datë 18.11.2016 “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licensave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit”, të ndryshuar”.

KOMISIONI VLERËSUES

- | | | |
|----|------------------|---------|
| 1. | Maksim Tashi | Kryetar |
| 2. | Arjan Budo | Anëtar |
| 3. | Flamur Mullisi | Anëtar |
| 4. | Eni Çulli | Anëtar |
| 5. | Nikolin Berxhiku | Anëtar |

MIRATOHET

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Gentian Këni

